

Përkthim, versioni i punës

Strasbourg, 17 mars 2025

CDL-AD(2025)013

KOMISIONI EVROPIAN PËR DEMOKRACI PËRMES LIGJIT
(KOMISIONI I VENECIAS)

MAQEDONIA E VERIUT

**MENDIM I PËRBASHKËT AMICUS CURIAE
I KOMISIONIT TË VENECIAS DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME PËR
DEMOKRACI DHE DINJITET NJERËZOT (DGII)
NË KËSHILLIN E EVROPËS**

**PËR STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE
PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE TË PAKICAVE *
NË JETËN PUBLIKE DHE NË PROCEDURAT GJYQËSORE**

**Miraturar në Seancën plenare të 142-të
të Komisionit të Venecias
(Venecia, 14-15 mars, 2025)
mbi bazën e komenteve:
znj. Veronika Bilkova (anëtare, Çeki)
z. Martin Kučer (anëtar, Holandë)
z. Jan Velars (anëtar, Belgjikë)
z. Matija Zeba (ekspert, „DGII“)**

Përmbajtja

I. Hyrje.....	1
II. Fushëveprimi i mendimit të përbashkët <i>amicus curiae</i>	1
III.Vërejtje paraprake	2
IV. Standardet ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat gjuhësore të pakicave	3
A. Pyetja e parë: Standardet ndërkombëtare dhe evropiane për përdorimin e gjuhëve të pakicave në jetën publike	4
1. Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare	5
2. Karata evropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave	7
B. Pyetja e dytë: Standardet ndërkombëtare dhe evropiane për përdorimin e gjuhëve të pakicave në procedurat gjyqësore dhe në gjyqësor.....	10
1. Standarde që zbatohen për të paditurin në procedurën penale.....	10
2. Standarde që zbatohen për palën në procedurat jo-penale.....	12
V. Konkluzioni.....	13

I. Hyrje

1. Me shkresë të datës 20 nëntor 2024, kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut kërkoi mendim *amicus curiae* nga Komisioni i Venecias në kontekstin e një lënde që është në procedurë para Gjykatës, në lidhje me kushtetutshmërinë e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, të miratuar nga Parlamenti në mars të vitit 2018.

2. Gjykata Kushtetuese i kërkoi Komisionit të Venecias t'u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

1. Cilat janë standardet ndërkombëtare dhe evropiane për përdorimin e gjuhëve të pakicave në jetën publike, përkatësisht në organet shtetërore dhe institucionet publike:

- Në nivel qendror (veçanërisht në lidhje me kriteret për përdorimin e gjuhëve të pakicave në të gjithë territorin e shtetit);

- Në nivel lokal (në njësitë e vetëqeverisjes lokale).

2. Cilat janë standardet ndërkombëtare dhe evropiane për përdorimin e gjuhëve në procedurat gjyqësore dhe në gjyqësor në përgjithësi?

3. Në përputhje me praktikën e tij, Komisioni i Venecias vendosi ta përgatisë këtë mendim së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme për Demokraci dhe Dinjitet Njerëzor ("DGII").

4. Në cilësinë e raportuesve për mendimin janë znj. Veronika Bilkova, z. Martin Kučer, z. Jan Vellars dhe z. Matia Zeba (ekspertë në "DGII").

5. Ky mendim i përbashkët *amicus curiae* është përgatitur mbi bazën e komenteve të raportuesve. Më 13 mars 2025, Nënkomiteti për të Drejtat Themelore, Mosdiskriminimin dhe Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në mbledhje e shqyrtoi draftin e mendimit *amicus curiae*. Komisioni i Venecias e miratoi atë në Seancën plenare të 142-të (Venecia, 14-15 mars 2025).

II. Fushëveprimi i mendimit të përbashkët *amicus curiae*

6. Komisioni i Venecias dhe "DGII" do t'i analizojnë dhe do t'u përgjigjen pyetjeve të ngritura nga Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut në lidhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane të zbatueshme për përdorimin e gjuhëve të pakicave në jetën publike dhe në procedurat gjyqësore dhe në gjyqësor në përgjithësi. Meqenëse kërkesa ka të bëjë me "*standardet ndërkombëtare dhe evropiane*" (një term që nuk kufizohet vetëm në standardet ligjorisht të detyrueshme, as në standardet që janë të detyrueshme për Maqedoninë e Veriut), ky mendim i përbashkët *amicus curiae* nuk do të fokusohet në specifikat e Maqedonisë së Veriut, por do t'i paraqesë standardet në një kontekst të përgjithshëm. Interpretimi i Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut dhe zbatimi i saj në rastin aktual mbeten kompetencë ekskluzive e Gjykatës Kushtetuese. Sipas kësaj, mendimi i përbashkët *amicus curiae* nuk do ta vlerësojë situatën faktike në lëndën që është në shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese, as përputhshmërinë e Ligjit

për Përdorimin e Gjuhëve me Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut, apo ndonjë projektligji tjetër të miratuar ose të propozuar.

7. Komisioni i Venecias kujton se më parë ka miratuar një Mendim mbi Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve të Maqedonisë së Veriut.¹

8. Komisioni i Venecias dhe "DGII" vërejnë se dy pyetjet e parashtruara janë shumë të gjera. Mendimi i përbashkët *amicus curiae* do të përqendrohet vetëm në aspektet më të rëndësishme të rregullimit ligjor në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, si Komisioni i Venecias ashtu edhe "DGII" vërejnë se pyetja e parë ka të bëjë me përdorimin e "gjuhëve të pakicave", pyetja e dytë ka të bëjë me përdorimin e "gjuhëve" si të tilla - megjithatë, nga konteksti i kërkesës rrjedh se të dyja pyetjet kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve të pakicave. E njëjta qasje do të ndiqet në mendimin e përbashkët *amicus curiae*.

III. Vërejtje paraprake

9. Që në fillim, Komisioni i Venecias dhe "DGII" dëshirojnë të theksojnë se standardet evropiane dhe ndërkombëtare që do të shqyrtohen duhet të konsiderohen si "*standarde minimale*". Kjo nuk i pengon shtetet të ofrojnë garanci më të gjera, me kusht që ato të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe detyrimet ndërkombëtare që i takojnë shtetit. Komisioni i Venecias ka deklaruar më parë se "*në parim është i lavdërueshëm*"² dhe „*meriton njohje*"³, nëse kuadri ligjor kombëtar i tejkalon standardet minimale evropiane dhe ndërkombëtare.

10. Megjithatë, nga perspektiva e sundimit të së drejtës, është po aq e rëndësishme që këto dispozita ligjore të zbatohen (mund të zbatohen) në praktikë.⁴ Komisioni i Venecias dhe "DGII" nënvizojnë se standardet evropiane dhe ndërkombëtare të analizuar në këtë mendim të përbashkët *amicus curiae* nuk janë vetëm përcaktimi i qartë i të drejtave gjuhësore të pakicave kombëtare nga normat ligjore. Zbatimi i duhur i Ligjit është një aspekt thelbësor i sundimit të së drejtës.⁵

11. Për më tepër, Komisioni i Venecias ka konfirmuar vazhdimisht se marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e pakicave kërkojnë që shtetet anëtare të gjejnë një ekuilibër të drejtë midis mbrojtjes së të drejtave gjuhësore të personave që u përkasin pakicave kombëtare, nga njëra anë, dhe ruajtjes së kohezionit midis grupeve të ndryshme gjuhësore në shtet, nga ana tjetër.⁶

12. Duke e pasur parasysh rëndësinë e së drejtës për të përdorur gjuhët e pakicave - me gojë dhe me shkrim, privatisht dhe publikisht, duke përfshirë - në kushte të caktuara

¹ [CDL-AD\(2019\)033](#) Maqedonia e Veriut – Mendim për Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve

² Njëjtë. [CDL-AD\(2019\)033](#), paragrafi 99

³ [CDL-AD\(2004\)026](#), Mali i Zi - Mendim për projektligjin e rishikuar për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare dhe etnike, paragrafi 41.

⁴ [CDL-AD\(2016\)007](#), Lista e verifikimit për sundimin e së drejtës, II.B.2 dhe II.A.7.

⁵ E cit. [CDL-AD\(2019\)033](#), paragrafi 78

⁶ [CDL-AD\(2011\)008](#) Ukraina – Mendim për Projektligjin e Gjuhëve, paragrafi 97. [CDL-AD\(2010\)035](#) Republika e Sllovakisë – Mendim për aktin për gjuhën shtetërore, paragrafi 47. [CDL-AD\(2012\)011](#) Hungari – Mendim për aktin për të drejtat e kombësive, paragrafi 73

- në komunikim me organet administrative - është thelbësore që çdo vendim që lidhet me politikat gjuhësore dhe gëzimin e të drejtave gjuhësore të miratohet në konsultim të ngushtë me përfaqësuesit e pakicave, për të siguruar që shqetësimet e personave që u përkasin pakicave kombëtare janë marrë parasysh në mënyrë adekuate dhe efektive.⁷

IV. Standardet ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat gjuhësore të pakicave

13. E drejta për të përdorur lirisht gjuhën e vet, privatisht dhe publikisht, me gojë dhe me shkrim është thelbësore për ruajtjen e identitetit gjuhësor. Të drejtat gjuhësore janë efektive vetëm nëse mund të gëzohen në sferën publike.

14. Marrëveshjet e përgjithshme për të drejtat e njeriut përfshijnë, në veçanti, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike (PNDQP), Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK) dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).^{*} PNDQP-ja dhe KEDNJ-ja e përmendin gjuhën në dispozitat e tyre mbi ndalimin e diskriminimit (neni 26 i PNDQP-së, neni 14 i KEDNJ-së dhe Protokoli 12 i KEDNJ-së) dhe në dispozitat e tyre mbi të drejtën për një gjykim të drejtë (Neni 14(3) i PNDQP-së dhe Neni 6(3) i KEDNJ-së). Përveç kësaj, PNDQP-ja parashikon se: *"në ato shtete në të cilat ekzistojnë pakica etnike, fetare ose gjuhësore, personave që u përkasin pakicave të tilla nuk do t'u mohohet e drejta, në bashkësi me anëtarët e tjerë të grupit të tyre, për të gëzuar kulturën e tyre, për të shpallur dhe praktikuar fenë e tyre, ose për të përdorur gjuhën e tyre"* (neni 27). Nuk ka asnjë dispozitë të ngjashme në KEDNJ.

15. Instrumente specifike ligjore (rajonale) që kryesisht kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve janë Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës (Konventa Kornizë) dhe Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave (Karta). Komisioni i Venecias vëren se Maqedonia e Veriut është shtet palë e Konventës Kornizë⁸, por se është vetëm nënshkruese e Kartës.

16. Konventa Kornizë përmban një sërë dispozitash gjithëpërfshirëse që synojnë mbrojtjen e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare, me theks të veçantë në të drejtat gjuhësore në nenet 5, 9, 10, 11, 12 dhe 14. Përdorimi i termit *"Kornizë"* në titull e thekson fleksibilitetin që u ofrohet shteteve palë në përshtatjen e dispozitave të gjera të Konventës Kornizë në një kontekst specifik kombëtar përmes ligjeve dhe politikave të përshtatshme kombëtare. Edhe pse Konventa Kornizë nuk jep një përkufizim të qartë të termit *"pakica kombëtare"*, shumica e shteteve palë kanë futur përkufizimet e tyre gjatë procesit të ratifikimit, me disa që përfshijnë grupe të caktuara ose që i potencojnë në mënyrë eksplicite pakicat për të cilat zbatohet Konventa

⁷ [Komenti tematik nr.3](#), Të drejtat gjuhësore të personave që i përkasin pakicave kombëtare sipas Konventës kornizë, të miratuar më 24 maj 2012, paragrafi 51.

PNDQP - International Covenant on Civil and Political Rights (ICCPR)

PNDESK - International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights (ICESCR)

KEDNJ - European Convention on Human Rights (ECHR)

⁸ Maqedonia e Veriut e ratifikoi Konventën Kornizë më 10.04.1997, ndërsa hyri në fuqi më 01.02.1998.

Kornizë.⁹ Në këtë mendim të përbashkët *amicus curiae* nuk do të hyhet në përkufizimin e termit "*pakica kombëtare*".

Karta ofron një qasje "*à la carte*", që do të thotë se shtetet përcaktojnë në mënyrë të pavarur se cilat gjuhë do të mbulohen dhe nivelin e mbrojtjes që do t'u jepet atyre. Ajo ndahet në dispozita të përgjithshme, dispozita të detyrueshme - të cilat zbatohen për të gjitha gjuhët rajonale dhe të pakicave të një shteti anëtar dhe dispozita që u lejojnë shteteve të zgjedhin se cilat gjuhë do t'i mbrojnë dhe cilat dispozita specifike do t'i zbatojnë (në fusha të tilla si arsimi, pushteti gjyqësor dhe ai administrativ, shërbimet publike, mediat dhe jeta kulturore, ekonomike dhe sociale).

Edhe Konventa Kornizë ashtu edhe Karta kanë krijuar mekanizma monitorimi. Komiteti Këshillimor i Konventës Kornizë dhe Komiteti i Ekspertëve të Kartës janë në mënyrë përkatëse kompetentë.

17. Komisioni i Venecias në të kaluarën i ka zbatuar këto instrumente të përgjithshme dhe specifike në analizën e legjislacionit që lidhet me përdorimin e gjuhëve në disa vende, siç janë Letonia¹⁰ Ukraina¹¹ dhe vetë Maqedonia e Veriut.¹²

18. Në nivelin e Bashkimit Evropian, në nenin 2 të Marrëveshjes për Bashkimin Evropian (TEU) përcaktohet se BE-ja është themeluar mbi vlera themelore, të tilla si barazia dhe respektimi i të drejtave të njeriut, "*duke i përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave*". Këto vlera përforcohen shtesë me Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së, në të cilën, edhe pse nuk parashikohen të drejta eksplicite për pakicat, megjithatë ndalohet diskriminimi për shkak të origjinës etnike, gjuhës, religjionit ose përkatësisë në një pakicë kombëtare, ndërsa në mënyrë shtesë riafirmohet se BE-ja e respekton diversitetin kulturor, religjioz dhe gjuhësor.

A.Pyetja e parë: Standardet ndërkombëtare dhe evropiane për përdorimin e gjuhëve të pakicave në jetën publike

19. Pyetja e parë e ngritur nga Gjykata Kushtetuese ka të bëjë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane për përdorimin e gjuhëve të pakicave në jetën publike, përkatësisht në organet shtetërore dhe institucionet publike në nivel qendror (veçanërisht në lidhje me kriteret për përdorimin e gjuhëve të pakicave në të gjithë territorin e shtetit) dhe në nivel lokal (njësitë e vetëqeverisjes lokale).

⁹ Lidhur me Maqedoninë e Veriut, sipas deklaratës së paraqitur nga ministri i Punëve të Jashtme më 16 prill 2004, termi "pakica kombëtare" i përdorur në Konventën kornizë zbatohet për qytetarët që jetojnë brenda kufijve të saj dhe që janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllah, popullit serb, popullit rom dhe popullit boshnjak.

⁹ [CDL-AD\(2020\)012](#), Letonia - Mendim mbi ndryshimet e fundit në legjislacionin për arsimin në gjuhët e pakicave.

⁹ [CDL-AD\(2019\)032](#), Ukraina - Mendim mbi Ligjin i cili siguron funksionimin e gjuhës ukrainase si gjuhë shtetërore

⁹ [CDL-AD\(2019\)033](#), Maqedonia e Veriut - Mendim për Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

¹⁰ [CDL-AD\(2020\)012](#), Letonia - Mendim mbi ndryshimet e fundit në legjislacionin për arsimin në gjuhët e pakicave.

¹¹ [CDL-AD\(2019\)032](#), Ukraina - Mendim mbi Ligjin i cili siguron funksionimin e gjuhës ukrainase si gjuhë shtetërore

¹² [CDL-AD\(2019\)033](#), Maqedonia e Veriut - Mendim për Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

20. Sipas Kartës, jeta publike i mbulon së paku fushat e mëposhtme: arsimin, procedurat gjyqësore (shih më poshtë), organet administrative dhe shërbimet publike, mediat, aktivitetet dhe institucionet kulturore, jetën ekonomike dhe sociale.¹³ Megjithatë, Komisioni i Venecias dhe „DGII“ vërejnë se kërkesa e Gjykatës Kushtetuese kufizohet në përdorimin e gjuhëve të pakicave në organet shtetërore dhe institucionet shtetërore (ky kufizim do të respektohet në mendimin e përbashkët *amicus curiae*).

21. PNDQP-ja dhe KEDNJ-ja nuk e përmbajnë përdorimin e gjuhëve të pakicave në jetën publike. E drejta për t'u përdorur gjuhë jozyrtare në komunikimin e autoriteteve publike nuk është njohur asnjëherë si e tillë nga Gjykata në praktikën e saj gjyqësore.¹⁴ Neni 27 i PNDQP-së personave pjesëtarë të pakicave kombëtare ua garanton të drejtën „që ta përdorin gjuhën e tyre“. Kjo e drejtë ka të bëjë edhe në përdorimin privat edhe në përdorimin publik të gjuhës. As në PNDQP, as në Komentin e përgjithshëm për nenin 27¹⁵, nuk përcaktohen detaje konkrete për zbatimin e tij.

1. Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

22. Neni 10(1) i Konventës Kornizë përcakton të drejtën e çdo personi që i përket një pakice kombëtare për të “përdorur lirisht dhe pa pengesa gjuhën e tij ose të saj të pakicës në shtëpi dhe në publik, me gojë dhe me shkrim”.¹⁶ Përveç kësaj, në nenin 10(2) parashihet që “në zonat e banuara nga persona që u përkasin pakicave kombëtare tradicionalisht ose në numër të konsiderueshëm, nëse këta persona e kërkojnë këtë dhe nëse një kërkesë e tillë korrespondon me një nevojë reale, palët do të përpiqen, brenda kufijve të mundësive të tyre, të sigurojnë kushte për përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet midis këtyre personave dhe autoriteteve administrative”. Sipas Arsytimit të Konventës Kornizë¹⁷, kjo dispozitë është formuluar “me fleksibilitet të madh, duke u lënë hapësirë për vendimmarrje diskrecionare nga shtetet palë”.¹⁸ Për shkak të sfidave financiare, administrative dhe teknike gjatë zbatimit të kësaj dispozite, me qëllim që “për t'i lejuar secilit vend t'i marrë në konsideratë rrethanat e veta konkrete”.¹⁹ Megjithatë, Komisioni i Venecias dhe „DGII“

¹³ Raporti shpjegues për Kartën Evropiane për Gjuhë Rajonale apo të Pakicave (shiko Pjesa III – Masa për zhvillimin e përdorimit të gjuhëve rajonale apo gjuhëve pakicë në jetën publike).

¹⁴ Shiko, për shembull, „Igor Dmitrijevs v. Latvia“, nr. 61638/00, paragrafi 85, 30 nëntor 2006, me referenca shtesë. Shiko gjithashtu „Paun Jovanović v. Serbia“, nr. 41394/15, paragrafi 89, 7 shkurt 2023.

¹⁵ Tashmë i cituar Komiteti i të Drejtave të Njeriut, [Koment i përgjithshëm](#), 23, neni 27

¹⁶ Sipas këtij neni, e drejta për të përdorur gjuhën e vet lirisht, privatisht dhe publikisht, me gojë dhe me shkrim është thelbësore për ruajtjen e identitetit gjuhësor. Sipas Komentit tematik nr.3 të Komitetit Këshillimor (paragrafi 51), “Të drejtat gjuhësore janë efektive vetëm nëse mund të gëzohen në sferën publike”.

¹⁷ Shiko paragrafët 64-66 të Arsytimit të Konventës kornizë

¹⁸ Shiko M. Vajler (e redaktuar) *Të drejtat e pakicave. Komenti për Konventën Evropiane Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*, Oxford University Press, 2005, 312: „Me nenin 10 paragrafi 2 “kufizime që u lënë palëve diskrecionin, duke përfshirë miratimin e frazave të tilla si “Palët do të përpiqen” dhe termave të tjerë që zbusin natyrën detyruese”.

¹⁹ Për shembull, ekzistenca e një “nevojë reale” duhet të vlerësohet nga shteti në bazë të kriterëve objektive, ndërsa formulimi “brenda kufijve të asaj që është e mundur” tregon se faktorë të ndryshëm, në veçanti burimet financiare të palës përkatëse, mund të merren në konsideratë. Në të njëjtën kohë, Konventa kornizë qëllimisht përmbahet nga përkufizimi i “rajoneve të banuara nga persona që i përkasin pakicave kombëtare tradicionalisht ose në numër të konsiderueshëm”. Do të ishte më e dobishme të miratohej një formulim fleksibël, i cili do të lejonte që rrethanat specifike të secilës Palë të merren në konsideratë. Termi „të banuar... me traditë“ nuk i referohet pakicave historike, por vetëm atyre që ende jetojnë në të njëjtin rajon gjeografik.

potencojnë se shtetet duhet të zbatojnë kritere objektive dhe ta respektojnë parimin e mosdiskriminimit.²⁰

23. Neni 10(2) i Konventës Kornizë i përcakton kushtet sipas të cilave gjuhët e pakicave mund të përdoren në komunikim me organet administrative, pa e cenuar statusin e gjuhës/gjuhëve zyrtare. Edhe pse shtetet janë të lira të përcaktojnë zonat ku pakicat jetojnë në "numër të konsiderueshëm", ato duhet të përcaktojnë kritere të qarta për termat "*numër i konsiderueshëm*" dhe "*numër mjaftueshëm i madh*" në mënyrë që të sigurohet zbatimi konsistent i këtyre të drejtave.

24. Komisioni i Venecias dhe "DGII" theksojnë se Komenti tematik nr.3 i Komitetit Këshillimor parashikon që mundësia e përdorimit të gjuhëve të pakicave në komunikim me organet administrative nuk mund të lihet ekskluzivisht në të drejtën diskrecione të autoriteteve lokale.²¹ Prandaj, duhet të vendosen procedura të qarta dhe transparente për zbatimin e përdorimit të gjuhëve të pakicave, përfshirë edhe në formë të shkruar, me qëllim sigurimin e gëzimit të barabartë të kësaj të drejte. Sfida kryesore në çdo qasje numerike është vendosja e pragjeve që nuk janë shumë të larta. Komisioni i Venecias dhe "DGII" vërejnë, për shembull, se pragjet prej 20% ose më të larta shpesh përbëjnë "*një pengesë të pakapërcyeshme për qasjen efektive në të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare*",²² ndërsa pragjet më të ulëta në përgjithësi janë pritur më mirë nga Komiteti Këshillimor, veçanërisht në nivel lokal.²³ Përveç kësaj, që të bëhet dallim midis të drejtave dhe shërbimeve të ndryshme, mund të zbatohen pragje të ndryshme. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se përdorimi zyrtar i gjuhëve të pakicave mund të përcaktohet edhe në rajone me një popullsi relativisht të vogël minoritare, me kusht që ato të jenë tradicionalisht të banuara nga ai grup, të ketë një kërkesë të paraqitur dhe të ketë një nevojë reale. Sipas Komitetit Këshillimor,²⁴ "*nevojë*" nuk nënkupton varësi nga një gjuhë pakicë për shkak të njohurive të pamjaftueshme të gjuhës zyrtare. "Një kërcënim për funksionalitetin e një gjuhe minoritare si mjet komunikimi në një rajon të caktuar është i mjaftueshëm për të përbërë një "nevojë" brenda kuptimit të nenit 10(2) të Konventës Kornizë."²⁵

25. Komisioni i Venecias dhe "DGII" nënvizojnë se Komenti tematik nr.3 i Komitetit Këshillimor për të Drejtat Gjuhësore²⁶ bën dallimin midis komunikimit me organet publike në nivel lokal dhe komunikimit me organet publike në nivel qendror. Lidhur me përdorimin e gjuhëve të pakicave në komunikimin me autoritetet administrative në nivel lokal, Komiteti Këshillimor i inkurajon shtetet të sigurojnë "*zbatimin maksimal të mundësive të parashikuara me ligj*". "*Autoritetet duhet të mbështesin dhe inkurajojnë në mënyrë aktive masa të tilla duke krijuar një mjedis të favorshëm për përdorimin e*

²⁰ Shiko gjithashtu Arsyetimin e Konventës Kornizë të Mbrojtës së Pakicave Kombëtare, 1 shkurt 1995, paragrafi 65

²¹ Koment tematik nr. 3 i KKDGJ paragrafi 55

²² Komiteti Këshillimor, Mendimi i katërt për Shqipërinë (2018), paragrafi 101

²³ Komiteti Këshillimor, Mendimi i pestë për Maqedoninë e Veriut (2022), paragrafi 96

²⁴ Komenti tematik tashmë i cituar nr.3, paragrafi 56

²⁵ Komenti tematik nr.3, paragrafi 53

²⁶ Njëjtë, paragrafi 58

gjuhëve të pakicave, duke përfshirë edhe ndarjen e burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore."²⁷

26. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Venecias dhe "DGII" arrijnë në përfundimin se, edhe pse shteteve u lihet një hapësirë e gjerë diskrecioni për të marrë parasysh specifikat e situatës së tyre faktike dhe të sistemeve të tyre ligjore, Konventa Kornizë kërkon që përdorimi i gjuhëve të pakicave në komunikim me autoritetet administrative t'i nënshtrohet kriterëve objektive dhe të bazohet në parimin e mosdiskriminimit. Konventa Kornizë është më e ndërlikuar në aspektin e zbatimit të mundësive të parapara me ligj, për të mundësuar përdorimin e gjuhëve të pakicave në komunikim me organet administrative në nivel lokal, duke marrë në të njëjtën kohë me kujdes parasysh situatën e atyre pakicave kombëtare dhe bashkësive gjuhësore, anëtarët e të cilave jetojnë në numër të konsiderueshëm jashtë rajoneve të tyre tradicionale (më shpesh në kryeqytete)²⁸. Komisioni i Venecias dhe "DGII" theksojnë se për zbatimin efektiv të përdorimit të gjuhëve të pakicave në jetën publike, shteti duhet të jetë i përgatitur të ofrojë burime të mjaftueshme për të garantuar zbatimin faktik të asaj që është përcaktuar me ligj. Në veçanti, kur ligji parashikon përkthimin e dokumenteve të caktuara,²⁹ me qëllim shmangien e barrës financiare shtesë dhe përpjekjeve administrative për komunat përkatëse, duhet të sigurohen burime shtesë administrative dhe/ose financiare.³⁰

2. Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave

27. Maqedonia e Veriut e ka nënshkruar Kartën, por nuk e ka ratifikuar atë. Pjesa III e Kartës përmban një sërë dispozitash specifike në lidhje me të cilat çdo shtet është i lirë, brenda kufijve të caktuar, të përcaktojë se cilat nga këto dispozita do të zbatohen për secilën prej gjuhëve që fliten në territorin e tij. Ky fleksibilitet i merr parasysh ndryshimet kryesore në situatën faktike të gjuhëve rajonale ose të pakicave (numri i folësve, shkalla e ndarjes, etj.). Në të njëjtën kohë, merren parasysh shpenzimet financiare që i sjellin shumica e këtyre dispozitave, si dhe kapaciteti i ndryshueshëm administrativ dhe financiar i shteteve evropiane.³¹ Neni 10 i Kartës (në Pjesën III) ka të bëjë me komunikimin midis autoriteteve publike dhe personave që i përdorin gjuhët e pakicave. Kjo dispozitë bën dallimin midis veprimit të organeve administrative të shtetit (përkatësisht në nivel qendror), veprimit të autoriteteve lokale dhe rajonale dhe veprimit të organeve që ofrojnë shërbime publike. Detyrimet e ndërmarra nga palët formulohen me fjalët "në masën e arsyeshme të mundshme" në lidhje me nenin 10(1) dhe 10(3). Kjo dispozitë synon të marrë në konsideratë faktin se disa nga masat e parashikuara kanë implikime të rëndësishme në aspektin e financave, të punësuarve ose trajnimit. Komisioni i Venecias dhe "DGII" theksojnë se pranimi i një detyrimi specifik në lidhje me

²⁷ Komenti tematik nr.3, paragrafi 58

²⁸ Komenti i tretë tematik për të drejtat gjuhësore, 2012, paragrafi 58.

²⁹ [CDL-AD\(2010\)035](#), Republika e Sllovakisë – Mendim për Ligjin e Gjuhës Shtetërore, paragrafi 84.

³⁰ [CDL-PI\(2022\)049](#), Përmbledhje e mendimeve dhe raporteve të Komisionit të Venecias që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pakicave kombëtare, paragrafi 38.

³¹ Raport shpjegues për Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale apo të Pakicave, paragrafi 23.

një gjuhë specifike nënkupton domosdoshmërisht një detyrim për të siguruar burimet dhe mekanizmat administrative të nevojshme për zbatimin efektiv të tij.

28. Detyrimet që lidhen me veprimin e organeve administrative të shtetit zbatohen *"brenda njësive administrative të shtetit, në të cilat numri i banorëve që përdorin gjuhë rajonale ose të pakicave justifikon masat e parashikuara dhe në varësi të situatës së secilës gjuhë"* (neni 10(1)). Shtetet kanë të drejtë të përcaktojnë kriteret për identifikimin e njësive të tilla, por këto kriterë duhet të përcaktohen dhe zbatohen në një mënyrë objektive. Shtetet marrin përsipër, *"për aq sa është e mundur në mënyrë të arsyeshme"*, të sigurojnë që ekziston mundësia e komunikimit, në një gjuhë rajonale ose të pakicave, midis individëve dhe autoriteteve administrative. Kjo dispozitë parashikon disa opsione nga të cilat shtetet mund të zgjedhin, duke filluar nga vetë autoritetet që përdorin gjuhën deri te mundësimi i përdoruesve të këtyre gjuhëve për të paraqitur kërkesa dhe/ose dokumente në ato gjuhë dhe/ose për të marrë një përgjigje në ato gjuhë. Në të njëjtën kohë, shtetet mund të angazhohen për të bërë të disponueshme tekstet dhe formularët administrativë të përdorur shpesh në gjuhë rajonale ose të pakicave ose në versione dygjuhëshe, dhe për t'u mundësuar autoriteteve administrative të hartojnë dokumente në një gjuhë rajonale ose të pakicave.

29. Detyrimet që lidhen me veprimin e autoriteteve lokale dhe rajonale zbatohen *"për autoritetet lokale dhe rajonale në territorin e të cilave numri i banorëve që përdorin një gjuhë rajonale ose të pakicave është i atillë që i justifikon [këto] masa"* (neni 10(2)). Shteteve u lihet përsëri e drejta me diskrecion për të përcaktuar se cilat rajone do të përfshihen, në bazë të kriterëve të drejta, objektive dhe të barabarta. Megjithatë, Komiteti i Ekspertëve ka theksuar vazhdimisht se pragjet prej 20% ose më të larta për përdorimin lokal të gjuhëve të pakicave në jetën publike nuk janë në përputhje me Kartën.³² Këtë herë, dispozitat i përfshijnë detyrimet për të mundësuar dhe/ose inkurajuar përdorimin e gjuhëve rajonale ose të pakicave brenda autoriteteve rajonale ose lokale; mundësinë e paraqitjes së propozimeve me gojë ose me shkrim për përdoruesit e gjuhëve rajonale ose të pakicave; publikimin e dokumenteve zyrtare nga autoritetet rajonale dhe lokale në gjuhët përkatëse rajonale ose të pakicave; përdorimin e gjuhëve rajonale ose të pakicave nga autoritetet rajonale në debatet në kuvendet e tyre, pa përjashtuar përdorimin e gjuhës/gjuhëve zyrtare të shtetit; përdorimin e gjuhëve rajonale ose të pakicave nga autoritetet lokale në debatet në kuvendet e tyre, pa përjashtuar përdorimin e gjuhës/gjuhëve zyrtare të shtetit; përdorimin ose pranimin, nëse është e nevojshme në kombinim me emrin e gjuhës/gjuhëve zyrtare, të formave tradicionale dhe të sakta të gjuhës rajonale ose të pakicave në emrat e vendeve.

30. Detyrimet që lidhen me sjelljen e organeve që i ofrojnë shërbimet publike zbatohen *"në territorin në të cilin përdoren gjuhë rajonale ose të pakicave, në përputhje me situatën e secilës gjuhë dhe në masën që kjo është realisht e mundur"* (neni 10(3)). Problemi, i cili pjesërisht rrjedh nga mungesa e fondeve të mjaftueshme, është për shkak të transferimit në rritje të shumë shërbimeve publike te subjektet private, për shkak të reduktimit të shpenzimeve publike. Këto ndërmarrje private mund të mos jenë

³² Komiteti i Ekspertëve, [Raporti i shtatë për vlerësim për Zvicrën](#) (2019), paragrafi 29; [Raporti i shtatë për vlerësim për Kroacinë](#) (2024), paragrafi 13.

të përgatitura të ofrojnë shërbime në disa gjuhë. Për këtë arsye, Komiteti i Ekspertëve të Kartës nënvizon se përdorimi publik i gjuhëve të pakicave "*ka të bëjë me shërbimet e ofruara nga autoritetet administrative ose nga ndërmarrjet private që veprojnë në emër të tyre*".³³

31. Komisioni i Venecias dhe "DGII" konsiderojnë se tri detyrimet, të cilat janë alternative për nga natyra, janë detyrime që gjuhët rajonale ose të pakicave të përdoren në ofrimin e shërbimeve; për t'u mundësuar përdoruesve të gjuhëve rajonale ose të pakicave të paraqesin një kërkesë dhe të marrin një përgjigje në këto gjuhë; ose për t'u mundësuar përdoruesve të gjuhëve rajonale ose të pakicave të paraqesin një kërkesë në këto gjuhë. Neni 10, gjithashtu parashikon që shtetet duhet të marrin masa shtesë, të tilla si përkthimi dhe interpretimi, si dhe punësimi ose trajnimi i duhur i nëpunësve publikë; dhe, me kërkesë të personave të tanguar, të mundësohet përdorimi ose pranimi i emrave famëjharë në një gjuhë rajonale ose të pakicave.

32. Si pasojë, brenda kuadrit të organeve administrative dhe shërbimeve publike, me nenin 10 secilit prej shteteve u lihet liri e madhe në vendosjen mbi përdorimin e gjuhëve rajonale ose të pakicave. Rregullativa duhet të marrë gjithmonë parasysh situatën specifike, e cila mund të ndryshojë dukshëm në shtete të ndryshme dhe për secilën gjuhë rajonale ose të pakicave veçmas.³⁴ Duke pasur parasysh këtë strukturë (institucionale) të Kartës, e cila u lejon shteteve të zgjedhin në mënyrë të pavarur nivele të ndryshme detyrimesh, Komisioni i Venecias dhe "DGII" arrijnë në përfundimin se standardet që rrjedhin nga Karta varen në një masë të madhe nga zgjedhjet e bëra nga shtetet. Megjithatë, është e rëndësishme që Karta bën dallimin midis komunikimit me autoritetet publike në nivel lokal dhe komunikimit me autoritetet publike në nivel qendror. Ndryshe nga formulimi "*në masën e arsyeshme të mundshme*" i përdorur në paragrafët 1 dhe 3, kushtet e paragrafit 2, ndërsa në veçanti detyrimi i palëve për të "*mundësuar dhe/ose inkurajuar*", janë formuluar në atë mënyrë që të merret në konsideratë parimi i autonomisë lokale dhe rajonale.³⁵ Komisioni i Venecias dhe "DGII" konsiderojnë se pritjet mund të jenë mjaft më të larta në lidhje me përdorimin e një gjuhe minoritare në komunikim me autoritetet në nivel lokal (në njësi ku numri i banorëve që përdorin atë gjuhë minoritare justifikon marrjen e masave), duke pasur parasysh se këto autoritete janë më afër qytetarëve. Në mënyrë të ngjashme, duhet bërë një dallim midis komunikimit nga autoritetet publike në raste individuale dhe komunikimit nga autoritetet publike në lidhje me tekstet dhe format e zbatueshme përgjithësisht. Në kategorinë e fundit, nga autoritetet mund të pritet "*në mënyrë të arsyeshme*" të marrin më shumë masa. Gjithashtu është e nevojshme të bëhet dallimi midis të drejtës së një personi që flasë një gjuhë pakice për t'u dhënë informacion autoriteteve në atë gjuhë (gjë që përbën një barrë më të vogël) dhe detyrimin të autoriteteve për t'u përgjigjur në atë gjuhë (gjë që përbën një barrë më të madhe).³⁶

³³ Komiteti i ekspertëve për Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave. [Raporti i pestë për Slloveninë](#) (2019), paragrafi 29.

³⁴ Raport shpjegues mbi Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, 5 nëntor 1992, paragrafi 103.

³⁵ Raport shpjegues mbi Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, 5 nëntor 1992, paragrafi 105.

³⁶ Njëjtë, paragrafi 3: "Parashitësat ose dokumentet me gojë ose me shkrim mund të dorëzohen në mënyrë legjitime në një gjuhë rajonale ose pakice, por pa asnjë detyrim për t'u përgjigjur në atë gjuhë."

33. Komisioni i Venecias dhe "DGII" kujtojnë "se dhënia e të drejtave gjuhësore individëve nënkupton marrjen përsipër të detyrimeve pozitive nga shteti, i cili duhet të sigurojë kuadro për të lehtësuar shërbimet gjuhësore në administratë".³⁷ Standardet evropiane dhe ndërkombëtare të diskutuara më sipër jo vetëm që nënkuptojnë se të drejtat gjuhësore të personave që identifikohen me pakica kombëtare duhet të përcaktohen me norma të qarta ligjore, por edhe se duhet të garantohet zbatimi konsistent i ligjit në praktikë - duke siguruar mjetet e nevojshme për të punësuar nëpunës publikë me aftësi të përshtatshme gjuhësore dhe/ose duke angazhuar përkthyes dhe interpretues të kualifikuar.³⁸

34. Komisioni i Venecias dhe "DGII" theksojnë se shtetet duhet të përdorin kritere objektive dhe të respektojnë parimin e mosdiskriminimit, duke siguruar njëkohësisht konsultimin me personat që identifikohen me pakicat kombëtare. Edhe pse me Konventën Kornizë inkurajohen masat që duhen marrë në nivel lokal në lidhje me komunikimin në përdorimin e një gjuhe pakicë me autoritetet administrative, Karta u lejon shteteve të zgjedhin nivele të ndryshme të detyrimeve shtesë, duke i marrë parasysh ndryshimet e mëdha në situatën faktike të gjuhëve rajonale ose të pakicave. Sidoqoftë, kjo duhet të shoqërohet me një detyrim për të siguruar burime të mjaftueshme si edhe për të marrë masa të përshtatshme administrative për ta mundur zbatimin efektiv.

B. Pyetja e dytë: Standardet ndërkombëtare dhe evropiane për përdorimin e gjuhëve të pakicave në procedurat gjyqësore dhe në gjyqësor

35. Pyetja e dytë ka të bëjë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane për përdorimin e gjuhëve në procedurat gjyqësore dhe në gjyqësor në përgjithësi.

1. Standardet që zbatohen për të paditurin në një procedurë penale

36. PNDQP-ja dhe KEDNJ-ja njohin të drejtën e çdo personi të paditur për një vepër penale për t'u informuar menjëherë për natyrën dhe shkakun e padisë "*në një gjuhë që ai/ajo e kupton*" (neni 14(3)(a) i PNDQP-së dhe neni 6(3)(a) i KEDNJ-së), si dhe të drejtën "*për të pasur ndihmën falas të një përkthyesi nëse ai/ajo nuk e kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjykatë*" (neni 14(3)(f) i PNDQP-së dhe neni 6(3)(e) i KEDNJ-së). Kjo e drejtë përsëritet edhe në Konventën Kornizë (neni 10(3)), për të cilën në Arsyetim theksohet se "*nuk shkon përtej garancive të përfshira në / KEDNJ/*".³⁹ Neni 5(3) i KEDNJ-së parashikon gjithashtu se "*çdokush që arrestohet duhet të informohet menjëherë, në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe për çdo akuzë kundër tij*".

37. Këto dispozita të KEDNJ-së, të cilat synojnë të garantojnë të drejtën e të paditurit për një gjykim të drejtë, i referohen një të padituri që nuk e kupton ose nuk flet gjuhën e

³⁷ [CDL-AD\(2019\)033](#), paragrafi 76, tashmë i cituar

³⁸ Komiteti Këshillimor, [Mendimi i katërt për Maqedoninë e Veriut](#) (2016), 64; [CDL-AD\(2019\)033](#) tashmë i cituar, paragrafi 76

³⁹ Shpjegim i Konventës Kornizë, tashmë i cituar, paragrafi 67

përdorur në gjykatë. Megjithatë, një i padituri që e kupton gjuhën zyrtare të shtetit nuk mund të këmbëngulë për shërbimet e përkthimit për të kryer mbrojtjen e tij në një gjuhë tjetër, përfshirë gjuhën e pakicës etnike të cilës i përket.⁴⁰

38. Sipas nenit 10(3) të Konventës Kornizë, *“Palët marrin përsipër të garantojnë të drejtën e çdo personi që i përket një pakice kombëtare për t’u informuar në afat sa më shkurtër të mundshëm, në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit dhe për natyrën dhe shkakun e padisë kundër tij, si dhe për t’u mbrojtur në këtë gjuhë, nëse është e nevojshme me ndihmën falas të një përkthyesi.”* Komiteti Këshillimor i Konventës Kornizë ka inkurajuar vazhdimisht organet kompetente të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur plotësisht të drejtat gjuhësore të pakicave në sistemin gjyqësor, duke përfshirë fazat hetimore dhe parahetimore.⁴¹

39. Komisioni i Venecias dhe “DGII” dëshirojnë të nënvizojnë se të drejtat e garantuara në nenin 14(3)(a) të PNDQP-së, nenin 6(3)(a) të KEDNJ-së dhe nenin 10(3) të Konventës Kornizë nuk përjashtojnë mundësinë e sigurimit të të drejtave më të gjera gjuhësore në procedurat gjyqësore, me kusht që të mos shkelen të drejtat e tjera të garantuara nga traktatet ndërkombëtare ose Kushtetuta, siç është e drejta për një gjykim të drejtë (brenda një afati të arsyeshëm).⁴²

40. Komisioni i Venecias ka deklaruar më parë se *“ofrimi i të drejtave gjuhësore individëve, nënkupton marrjen përsipër të detyrimeve pozitive nga shteti, i cili duhet të sigurojë kuadro për të lehtësuar shërbimet gjuhësore në gjyqësor”*.⁴³ Komiteti Këshillimor shpesh ka vërejtur se, pavarësisht ekzistencës së dispozitave të përshtatshme ligjore, kjo e drejtë nuk zbatohet në mënyrë të vazhdueshme për shkak të burimeve të pamjaftueshme financiare dhe/ose mungesës së përkthyesve të kualifikuar - veçanërisht për gjuhët e pakicave më të vogla. Prandaj, nuk mjafton vetëm miratimi i dispozitave të përshtatshme ligjore, por gjithashtu është e nevojshme të sigurohen burimet financiare për angazhimin e përkthyesve dhe interpretëve të kualifikuar.

41. Nga ana tjetër, neni 9(1)(a) i Kartës shkon përtej standardeve të përcaktuara në KEDNJ.⁴⁴ Duke parashikuar një qasje *“à la carte”*, parashikohet që shtetet - palë të marrin përsipër *“në lidhje me ato njësi gjyqësore në të cilat numri i banorëve që përdorin gjuhë rajonale ose pakicash i justifikojnë masat e përmendura më poshtë”* dhe *“me kusht që përdorimi i këtyre mundësive të mos konsiderohet nga gjykatësi si pengesë për zbatimin e duhur të drejtësisë”*, t’i zhvillojnë procedurat penale në gjuhën e pakicës dhe/ose t’i lejojnë të paditurit të përdorë gjuhën e tij të pakicës dhe/ose të paraqesë dokumente dhe kërkesa në atë gjuhë. Përveç kësaj, kërkesat dhe provat, qofshin të shkruara ose me gojë, të paraqitura në një gjuhë rajonale ose të pakicave nuk duhet të konsiderohen të papranueshme. *“Nëse është e nevojshme”*, organet gjyqësore duhet të ofrojnë shërbime falas përkthimi dhe interpretimi.

⁴⁰ Udhëzon [Udhëzuesi](#) për nenin 6 KEDNJ (penale), faqe. 574.

⁴¹ Komente tematike nr.3, paragrafi 59

⁴² [CDL-AD\(2019\)033](#), tashmë e cituar, paragrafi 89

⁴³ [CDL-AD\(2019\)033](#), gjithashtu, paragrafi 76

⁴⁴ Raporti shpjegues mbi Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, tashmë i cituar, paragrafi 95

42. Duke pasur parasysh strukturën e përgjithshme të Kartës dhe formulimin e përdorur në nenin 9 të Kartës, Komisioni i Venecias dhe „DGII“ e konsiderojnë të vështirë përcaktimin e një standardi të saktë në këtë drejtim, ndërkohë që theksojnë gjithashtu se dispozita *"pasqyron qëllimin (...) për të mbrojtur parimet themelore të sistemit gjyqësor, siç janë barazia e palëve dhe shmangia e vonesave të pajustificuara në procedurat gjyqësore dhe gjithashtu edhe mbrojtje nga abuzimet e mundshme të mundësive të ofruara për përdorimin e gjuhëve rajonale ose të pakicave"*.⁴⁵

43. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Venecias dhe „DGII“ arrijnë në përfundimin se, nëse i paditurit në procedurat penale nuk e kupton gjuhën shtetërore të përdorur në gjykata, atëherë zbatohen standardet ligjërish të detyrueshme të KEDNJ-së (përveç dispozitave të Kartës), ndërsa nëse i padituri në procedurat penale e kupton gjuhën shtetërore, por dëshiron të shprehet në *"gjuhën që është më e afërt emocionalisht me të"*, atëherë zbatohet neni 9 i Kartës (nëse shteti e ka ratifikuar Kartën).

44. E drejta për të përdorur gjuhën e pakicës nuk kufizohet vetëm tek personat që i përkasin asaj pakice. Në rastet e *Bickel dhe Franz* (1998) dhe *Rüffer* (2014), Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka vendosur se diskriminimi do të ekzistonte nëse një shtet lejonte përdorimin e një gjuhe të caktuar pakice në procedurat gjyqësore vetëm për qytetarët e vet. Megjithatë, këto raste janë zgjidhur bazuar në standardet e Bashkimit Evropian.

2. Standardet që zbatohen për palën në procedurat jo-penale

45. Lidhur me procedurat jo-penale, Komiteti Këshillimor vetëm konstaton se e përshëndet garantimin e të drejtës për interpretim në gjuhën e pakicës në procedurat civile dhe administrative në përputhje me Konventën Kornizë.⁴⁶

46. Karta shkon përtej kësaj Kornize, dhe neni 9 (i cili parashikon një qasje *"à la carte"*) rregullon përdorimin e gjuhëve në procedurat gjyqësore në mënyrë më të detajuar. Siç e kanë vënë në dukje më parë Komisioni i Venecias dhe „DGII“, kjo dispozitë *"përmban standardet më të larta evropiane për përdorimin e gjuhëve të pakicave në procedurat gjyqësore"*.⁴⁷ Në veçanti, përcaktohet që shtetet palë marrin përsipër *"në lidhje me ato njësi gjyqësore në të cilat numri i banorëve që përdorin gjuhë rajonale ose pakicash justifikon masat e përmendura më poshtë"* dhe *"me kusht që përdorimi i këtyre mundësive të mos konsiderohet nga gjykatësi si pengesë për zbatimin e duhur të drejtësisë"* të zhvillojnë procedurat në një gjuhë pakice me kërkesë të njëjës prej palëve, dhe/ose të lejojnë paditësin/të paditurin të përdorë gjuhën e tij/saj të pakicës nëse ai/a jo paraqitet personalisht para gjykatës, dhe/ose të paraqesë dokumente dhe prova në atë gjuhë. Këto detyrime mund të përmbushen ose me përdorimin e drejtpërdrejtë të gjuhëve rajonale ose të pakicës ose me angazhimin e përkthyesve dhe interpretuesve (pa kosto shtesë për personat e tanguar). Neni 9(2) dhe (3) gjithashtu

⁴⁵ Raporti shpjegues mbi Kartën e Gjuhëve për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, tashmë i cituar, paragrafi 91

⁴⁶ Komiteti Këshillimor, Komenti tematik nr.3 (2012), paragrafi 59

⁴⁷ [CDL-AD\(2019\)033](#), tashmë e cituar, paragrafi 83

parashikon detyrimin të mos kontestohet vlefshmëria e dokumenteve ligjore të hartuara në një gjuhë rajonale ose pakice dhe për të siguruar disponueshmërinë e teksteve më të rëndësishme ligjore kombëtare në gjuhët rajonale ose të pakicës.

47. Megjithatë, duke pasur parasysh strukturën e përgjithshme të Kartës dhe formulimin e përdorur në nenin 9 (sipas të cilit shtetet duhet të zgjedhin të paktën një nga nënpikat si minimum), Komisioni i Venecias dhe „DGII“, përsëri e konsiderojnë të vështirë përcaktimin e një standardi të saktë në këtë drejtim. Edhe pse neni 9 i Kartës parashikon një nivel të lartë mbrojtjeje, ai megjithatë u lë shteteve një liri të madhe në vendimmarrje për detyrimet që do të ndërmarrin.

V. Konkluzion

48. Me anë të shkresës së datës 20 nëntor 2024, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut kërkoi një mendim *amicus curiae* mbi dy çështje që kanë të bëjnë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare mbi përdorimin e gjuhëve të pakicave në jetën publike dhe në procedurat gjyqësore. Duke pasur parasysh se pyetjet e parashtruara trajtohen në formë abstrakte, mendimi i përbashkët *amicus curiae* nuk drejtohet te specifikat e Maqedonisë së Veriut, por i paraqet standardet në mënyrë të përgjithshme. Meqenëse kërkesa ka të bëjë me *"standardet ndërkombëtare dhe evropiane"* (një term që nuk kufizohet vetëm me standardet ligjërish të detyrueshme, as me standardet që janë të detyrueshme për Maqedoninë e Veriut), ky mendim i përbashkët *amicus curiae* nuk do të përqendrohet te specifikat e Maqedonisë së Veriut, por do t'i paraqesë standardet në një kontekst të përgjithshëm. Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut, Komisioni i Venecias dhe „DGII“ arritën në konkluzionet e mëposhtme:

49. Standardet evropiane dhe ndërkombëtare që u morën në konsideratë duhet të konsiderohen si "standarde minimale". Për më tepër, këto standarde nuk nënkuptojnë vetëm përcaktimin e qartë të të drejtave gjuhësore në normat ligjore, por edhe detyrimin për të garantuar zbatimin e qëndrueshëm të ligjit në praktikë, duke siguruar mjetet e nevojshme. Zbatimi i duhur i ligjeve është një aspekt thelbësor i sundimit të së drejtës. Shtetet janë të detyruara të mbajnë përgjegjësi për pasojat e zgjedhjeve të tyre në lidhje me politikat gjuhësore të pakicave, duke pasur parasysh lirinë e lënë për vendimmarrje.

50. Komisioni i Venecias dhe „DGII“ dëshirojnë të theksojnë se shtetet duhet të zbatojnë kritere objektive dhe të respektojnë parimin e mosdiskriminimit, duke siguruar njëkohësisht konsultimin me grupet e pakicave. Edhe pse me Konventën Kornizë nxiten masat që duhen marrë në nivel lokal në lidhje me komunikimin në gjuhët e pakicave me organet administrative, Karta u lejon shteteve të zgjedhin nivele të ndryshme të detyrimeve shtesë, duke marrë parasysh ndryshimet e mëdha në situatën faktike të gjuhëve rajonale ose të pakicave. Sidoqoftë, kjo duhet të shoqërohet me detyrimin për të siguruar burime të mjaftueshme dhe për të marrë masa përkatëse administrative për të siguruar zbatimin efektiv.

51. Komisioni i Venecias dhe „DGII“ konsiderojnë se është e vështirë të ofrohet një listë e plotë e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare të zbatueshme për përdorimin e gjuhëve të pakicave në jetën publike, duke pasur parasysh situatat e ndryshme që rrjedhin nga gjendja e ratifikimit të instrumenteve përkatëse, si dhe në bazë të lirisë së vlerësimit të lënë të shteteve përmes qasjes "à la carte", e cila u lejon atyre të marrin në konsideratë specifikat e situatës së tyre faktike në sistemet e tyre juridike. Komisioni i Venecias dhe „DGII“ konsiderojnë se pritjet mund të jenë në mënyrë të arsyeshme më të larta në lidhje me përdorimin e një gjuhe të pakicës në komunikimin me organet në nivel lokal (në një zonë ku numri i banorëve që përdorin atë gjuhë e justifikon marrjen e masave), duke pasur parasysh se këto janë organet publike më të afërta me qytetarët. Në mënyrë të ngjashme, duhet të bëhet dallim midis komunikimit të autoriteteve publike në raste individuale dhe komunikimit të autoriteteve publike për tekste dhe formularë me zbatim të përgjithshëm. Në kategorinë e fundit, nga autoritetet mund të pritet "*në mënyrë të arsyeshme*" të marrin më shumë masa. Gjithashtu, duhet bërë një dallim midis të drejtës së një personi që flet një gjuhë të pakicës për t'u dhënë informacion autoriteteve në atë gjuhë (gjë që përbën një barrë më të vogël) dhe detyrimit të autoriteteve për t'u përgjigjur në atë gjuhë (gjë që përbën një barrë më të madhe).

52. Komisioni i Venecias dhe „DGII“ arrijnë në konkluzion se shtetet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e plotë të të drejtave gjuhësore të pakicave në sistemin gjyqësor dhe për të ofruar garanci për një gjykim të drejtë, duke përfshirë fazat hetimore dhe parahetimore, mbi të gjitha në kontekstin e procedurave penale. Detyrimet që lidhen me procedurat penale, të cilat synojnë të garantojnë të drejtën për një gjykim të drejtë të të paditurve, përbëjnë thelbin e Rregullativës mbi përdorimin e gjuhëve të pakicave në gjyqësor. Megjithatë, këto janë standarde minimale dhe asgjë nuk i pengon shtetet të garantojnë të drejta më të gjera gjuhësore në procedurat gjyqësore, me kusht që kjo të mos pengojë zbatimin e drejtë të drejtësisë. Nëse bëhet një zgjedhje e tillë, është edhe më e rëndësishme të sigurohen burime të mjaftueshme financiare, të cilat do të lejojnë zbatimin e dispozitave ligjore.

53. Komisioni i Venecias dhe „DGII“ mbeten në dispozicion të Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut për ndihmë të mëtejshme lidhur me këtë çështje.